



Oda e Stomatologëve të Kosovës
Stomatološka Komora Kosova • Dental Chamber of Kosovo

KËSHILLI DREJTUES I ODËS SË STOMATOLOGËVE TË KOSOVËS (OSK), në mbështetje të nenit 21, paragrafi 1, me nënparagrafin 1.4 të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësor nr. 04/L-150, neni 27, paragrafi 1 me nënparagrafin 1.4 të Statutit të OSK-së, dhe Regullores për dhënien e dekoratave të OSK-së me nr. prot.2321 të dt.12.04.2022, në mbledhjen e mbajtur me 11.05.2022, nxjerrë këtë:

**RREGULLORE MBI PUNËN E KOMISIONIT VLERËSUES PËR DHËNIEN E
DEKORATAVE NË OSK**

- I. Me këtë akt normativ përcaktohet fushëveprimi i Komisionit, kompetencat dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me punën e Komisionit
- II. Fushëveprimi i Komisionit konsiston në mbledhjen dhe shqyrtimin e propozimeve për dhënien apo revokimin e dekoratave dhe çmimeve vjetore dhe përgatit propozimin përfundimtar, konform rregullores në fuqi.
- III. Propozimet e shqyrtuara nga Komisioni i dergohen Këshillit Drejtues për miratim.
- IV. Detyrat administrative për nevojat e Komisionit ofrohet nga Shërbimi Profesional i Odës.

- V. Asistenca juridike e Komisionit i ofrohet nga Zyrtari Ligjor e Shërbimit Profesional të Odës.
- VI. Mbledhja e Komisionit mund të mbahet nëse janë të pranishëm të paktën me shumë se gjysma e anëtareve të Komisionit.
- VII. Asistenti administrativ i Komisionit duhet t'i njoftojë përmes emailit, anëtarët e Komisionit për datën dhe kohën e mbajtjes së mbledhjes së paku tre ditë pala mbledhjes së caktuar.
- VIII. Anëtarët e Komisionit votojnë hapur dhe vendimi mbi propozimin përfundimtar të Komisionit është i vlefshëm nëse më shumë se gjysma e anëtareve të pranishëm kanë votuar për vendimin.
- IX. Revokimi i dekoratës nga ana e Komisionit bëhet vetëm duke u bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga parashtuesi i kërkesës për revokim të dekoratës.
- X. Në rastet kur Komisioni, përballat me probleme që dalin jashtë fushës së kompetencave e përgjegjësiive të tij, i drejtohet organit që e ka emëruar me shkrim për problematikën e hasur.

I dërgohet

Anëtarëve të komisionit

Shërbimit Profesional

Kryesuesi i Këshillit Drejtues

Prof.Dr. Blerim Kamberi


